



Datë: 14.04.2025

Numër Protokolli: 2589/2025

A.nr.309/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Ylber Fetahaj- si procesmbajtës, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.309/2025 të datës 12.02.2025, të parashtruar nga ankuesi S.R, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*Kërkese nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.309/2025, e datës 12.02.2025, e parashtruar nga ankuesi S.R.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil S.R (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 12.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 952/2025 të regjistruar nën shenjen A.nr.309/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në raport me kërkesën e tij lidhur me klasifikimin e pozitës së punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit S.R , **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, konkretisht sipas Kontratës së Punës të datës 01.12.2010 e vazhduar me datën 30.06.2018 ku është caktuar në pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Peje, ankuesi me datën 20.08.2024 ju ka drejtuar me një emali zyrtar përmes cilës ka kërkuar kompensim për shkak të incidenti që kishte pasur në vendin e punës ndërsa me datën 17.01.2025 ka përsëritur kërkesën të organi të punësimit duke kërkuar një përgjigje lidhur me çështjen e ngritur ku deri me tani nuk ka marr përgjigje në lidhje me kërkesën e tij.

Ankuesi, me datë 12.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative në raport me kërkesën e tij, mbi pretendimet për të kërkuar përgjigje nga organi i punësimit për çështjet e ngritura pasi që deri me tani nuk ka marr asnjë përgjigje.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 12.02.2025 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 17.01.2025 te organi i punësimit dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të parakohshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.309/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.R.;
- Udhëheqësit së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues te Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.